



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.59

Prishtinë, më 13.7.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-II

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Ismajl Kurteshi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Sergjan Popoviq, Bekim Haxhiu, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësues të KDI –së dhe mediat.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.6.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-050 për Kinematografinë;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i mbledhjes konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 28.6.2016

Procesverbali nga mbledhja e mbajtur më 17.6.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L-050 për Kinematografinë

Kryetari i Komisionit tha se lidhur me projektligjin për Kinematografinë janë mbajtur disa mbledhje, si dhe dy dëgjime publike. Komisionet e përhershme kanë proceduar raportet e tyre lidhur me amendamentet e Komisionit Funkcional për projektligjin Kinematografinë.

Komisioni me shumicë votash, vendosi që raportin me rekomandime për Projektligjin nr. 05/L – 050 për Kinematografinë ta procedojë për lexim të dytë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Komisioni shqyrtoi nen për nen Projektligjin nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe propozoi amendamentet si vijon:

Amendamenti 1

Neni 2 i projektligjit, nënpragrafi 1.21 riformulohet si vijon:

1.21 “Ritransmetim kabllor” është ritransmetimi i njëkohshëm, i pandryshuar dhe i pandërprerë te publiku, nëpërmjet sistemit me tel, mediumet optike dhe mikrovalore për marrjen nga publiku të transmetimit që vjen nga një organizatë tjetër transmetuese.

Amendamenti 2

Pas nenit 3 të projektligjit shtohet nen i ri si vijon:

Në nenin 12 të Ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.8 shtohet nënparagraf i ri 1.9 me tekstin si vijon:

1.9. Lajmet e ditës dhe informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të mediave mund të riprodhohen vetëm pasi të kenë kaluar së paku 12 (dymbëdhjetë) orë nga publikimi i tyre.

Amendamenti 3

Në nenin 4 të projektligjit, neni 12C riformulohet si vijon:

Neni 12C

Burimet e kërkimit të plotë

1. Burimet që duhet konsultohen për të kryer kërkimin e plotë të paraparë në nenin 12B, për kategorinë përkatëse të veprave janë:

1.1. Për librat e publikuara:

1.1.1. Deponimet ligjore, katalogët e bibliotekave dhe dokumentacionin që kanë në dispozicion bibliotekat dhe institucionet e tjera;

1.1.2. Shoqatat e botuesve dhe autorëve në Republikën e Kosovës;

1.1.3. Bazat e të dhënave dhe regjistrat si WATCH (Shkrimtarët, artistët dhe mbajtësit e të drejtave të tyre të autorit), ISBN (Numri Standard Ndërkombëtar i Librit) dhe bazat e të dhënëve që i listojnë librat e shtypura;

1.1.4. Bazat e të dhënave të shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht shoqatave që mbajnë të drejtat e riprodhimit;

1.1.5. Burimet që përmbajnë bazat e të dhënave dhe regjistrat, përfshirë VIAF (Autoriteti Ndërkombëtar i Dokumenteve Virtuale) dhe ARROW (Regjistrat me Qasje në Informacionin e Drejtave dhe Veprave Jetime).

1.2. Për gazeta, revista, revista profesionale dhe publikime periodike:

1.2.1. ISSN (Numri Standard Ndërkombëtar i Botimeve Serike) për publikimet periodike;

1.2.2. Indekset dhe katalogët nga bibliotekat dhe koleksionet;

1.2.3. Deponimet ligjore, përkatësisht të bibliografive kombëtare dhe të veçanta;

1.2.4. Bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i mirëmbajtur nga shoqatat e botuesve dhe shoqatat e gazetarëve në Republikën e Kosovës;

1.2.5. Bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i shoqatave për administrim kolektiv, përfshirë organizatat e të drejtave të riprodhimit.

1.3. Për veprat virtuale, përfshirë veprat e arteve të bukura, fotografinë, ilustrimin, dizajnin, arkitekturën, skeçet e veprave të përmendura së fundi, si dhe veprat që janë pjesë e librave, revistave profesionale, gazetave dhe revistave ose pjesë e veprave të tjera:

1.3.1. Burimet e përmendura në paragrafët 1 dhe 2;

1.3.2. Bazat e të dhënave dhe dokumentacionin e shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht për artet pamore, dhe duke përfshirë edhe organizatat e të drejtave të riprodhimit;

1.3.3. Bazat e të dhënave të shoqatave të fotografisë, kur janë të aplikueshme.

1.4. Për veprat audio-vizuale dhe fonograme:

1.4.1. Deponimet ligjore;

1.4.2. Bazat e të dhënave dhe dokumentacioni që kanë shoqatat e prodhuesve në Republikën e Kosovës;

1.4.3. Bazat e të dhënave dhe dokumentacioni për film dhe fonograme të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe bibliotekave kombëtare;

1.4.4. Bazat e të dhënave me standarde dhe identifikues si ISAN (Standardi Ndërkombëtar i Numrit Audio-vizual), për material audio-vizual, ISWC (Standardi Ndërkombëtar i Kodit për Veprat Muzikore) për fonograme;

1.4.5. Bazat e të dhënave dhe dokumentacionin e shoqatave për administrim kolektiv, përkatësisht për autor, interpretues, prodhues të fonogrameve dhe prodhues të materialit audio-vizual;

1.4.6. Meritat dhe informatat e tjera që janë të shkruara në paketimin e veprës ose lëndës së mbrojtur me drejtat e përafërta;

1.4.7. Bazat e të dhënave dhe dokumentacioni i shoqatave të tjera relevante që përfaqësojnë kategori specifike të mbajtësve të të drejtave.

Amendamenti 4

Neni 17 i projektligjit, ndryshohet si vijon:

Neni 137, paragrafi 1 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

1. Të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin 50 (pesëdhjetë) vjet që nga interpretimi i bërë. Nëse fiksimi i performances nuk është në fonogram, por brenda kësaj periudhe në mënyrë të ligjshme publikohet ose i komunikohet publikut, të drejtat e interpretuesit zgjasin 50 vjet nga dita e publikimit të parë, ose e komunikimit të parë në publik, varësisht se cili veprim ka ndodhur më parë. Nëse interpretimi i fiksuar në një fonogram është publikuar në mënyrë të ligjshme ose në mënyrë të ligjshme i është komunikuar publikut brenda kësaj periudhe, të drejtat të zgjasin 70 vjet nga data e publikimit të parë të tillë ose nga komunikimi e parë i tillë në publik, varësisht se cili veprim ka ndodhur më parë.

Amendamenti 5

Neni 21 i projektligjit, ndryshohet si vijon:

Paragrafi 3 i nenit 161 të Ligjit bazik riformulohet, ndërsa pas paragrafit 5 shtohet paragrafi i ri 6, me tekstin si vijon:

3. Të drejtat në paragrafin 2 të nenit 20 të këtij ligji administrohen nga shoqata për administrim kolektiv të të drejtave pa autorizimin e autorit dhe bartësit të së drejtës.

6. Gjatë kohës kur të drejtat janë të bartura në një shoqatë kolektive, përmes ligjit apo me autorizim, autori nuk mundet të menaxhojë të njëjtat të drejta individualisht.

Amendamenti 6

Pas nenit 27 të projektligjit shtohet neni i ri si vijon:

Neni 190, paragrafit 1, neni 191, paragrafit 1 dhe neni 192, paragrafit 1 të Ligjit bazik, pas fjalëve “person juridik” shtohet teksti si vijon: “ose biznes individual”.

Amendamentet e propozuara u miratuan me shumicë votash, ndërsa abstenoj Mufera Sinik.

Raporti me amendamentet e propozuara procedohet te Komisionet e përhershme për vlerësim.

5. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti: Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani